

Numri i lëndës: 2021:061494

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05436207

**CP.nr.74/2021**

**Gjykata Themelore Gjilan dega e V.së**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Alush Sinani, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditores S.R.nga fshati P. Komuna e V.së, të cilin e përfaqëson M.H.avokate në V., ndaj debitorit Komuna e V.së, Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike kompensimi i pagave jubilarë dhe shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit ditor, në shumë prej 1,824.45 euro, gjykata jashtë seancës gjyqësore më datë 11.03.2024 bie këtë:

### **A K T V E N D I M**

I.Përfundohet, procedura përmbartimore e kreditores S.R.nga fshati P. Komuna e V.së, të cilin e përfaqëson M.H.avokate në V., ndaj debitorit Komuna e V.së, Drejtoria Komunale për Arsim.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore Gjilan dega e V.së, kishte lejuar propozimin me nr. CP.nr.74/2021, të datës 14.04.2021, ndaj kreditores S.R.nga fshati P. Komuna e V.së, të cilin e përfaqëson M.H.avokate në V., ndaj debitorit Komuna e V.së, Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike kompensimi i pagave jubilarë dhe shpenzimeve të ushqimit ditor, në shumë prej 1,824.45 euro sipas dokumentit përmbartues akgyjkimi C.nr.468/18 të datës 12.01.2021.

Gjykata, ka pranuar parashtrësën nga ana e të autorizuarit të kreditores, nga e cila parashtrësë ishte konfirmuar se debitori e ka përmbushur detyrimin në tërësi.

Gjykata pas vlerësimit të parashtrësës konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, që të përfundohet procedura përmbartimore ndaj debitorit duke u bazuar në parashtrësën e paraqitur, pranë kësaj Gjykate.

Pasi që gjykata ka konstatuar se debitori e kishte përmbushur detyrimin ndaj kreditores, gjykata konform nenin 42 parag.2 dhe 66 parag. 4 të LPP-së, ka përfunduar procedurën duke vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi

Andaj, në bazë të dispozitave të nenit 66 par.4 të LPP-së, dhe duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS V.**

**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL**  
**2021:061494, 11.03.2024**  
**CP.nr.74/2021**

**Gj y q t a r i**

---

**Alush Sinani**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh  
nga dita e pranimet të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.